

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 1 nga 3 |

Kodi: 057

## ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË SHEKULLIT XXI NË MATEMATIKË

**Tipi i programit: Themelor**

**Hyrje:**

Programi i trajnimit “Zhvillimi i shkathtësive të shekullit XXI në matematikë” është zhvilluar nga KEC, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor, i financuar nga USAID, për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit XXI tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Programi është hartuar nga një ekip i përbërë nga konsulentë vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e matematikës.

Pasi është akredituar në vitin 2013, programi është ofruar për mbi 1600 mësimdhënës, si dhe janë krijuar 185 fasilitatorë shkollorë përmes të cilëve është ofruar ky kurs. Mësimdhënësit pjesëmarrës dhe fasilitatorët shkollorë kanë dhënë sugjerimet/rekomandimet për përmirësimin e aspekteve të caktuara të programit, prandaj programi është përshtatur vazhdimisht.

**Qëllimet e kursit:**

- Të kuptuarit e matematikës si shkencë e modeleve dhe e raporteve dhe si një shkencë që zbatohet në situata të ndryshme në jetën e përditshme,
- Ngritja e vetëdijes për qasjet, burimet dhe teknologjitë e reja në mësimdhënien e matematikës,
- Paraqitja e rolit të hulumtimeve matematikore në zhvillimin e shkathtësive të shek. XXI siç janë: zgjidhja e problemeve, puna ekipore, të menduarit kritik dhe TIK-u në mesin e nxënësve tuaj,
- Ofrimi i ideve praktike për t’u përdorur në orët e matematikës,
- Përmirësimi i arritjeve të nxënësve në matematikë.

**Rezultatet e pritura**

Pas përfundimit të programit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë procesin e hulumtimit në matematikë;
- Kuptojnë strategjitë sipas Polyas për zgjidhjen e problemeve;
- Kuptojnë për hulumtimet e reja në lidhje me zhvillimin e fëmijëve dhe zhvillimin e trurit;
- Organizojnë aktivitete në klasë për të zgjeruar të kuptuarit e numrit të nxënësit;
- Organizojnë probleme praktike në klasat e tyre;
- Shpjegojnë konceptet matematikore nëpërmjet shembujve konkretë nga përditshmëria;
- Mësojnë disa lojëra që mund të ndërlihen me njësitë përkatëse nga matematika;
- Njihen me punën e kalkulatorit dhe programeve kompjuterike (Geogebra, Excel, Logo);

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 2 nga 3 |

- Njihen me disa burime të rëndësishme në internet;
- Kërkojnë, përmes makinave të kërkimit, për burime të tjera të informacionit, e që lidhen drejtpërdrejt me punën e tyre të përditshme në shkollë.

### Përmbajtja

Programi i trajnimit ka dozë të madhe të ndërveprimit, ku pjesëmarrësit angazhohen në njohjen e koncepteve, në punë hulumtuese dhe praktikim të teknikave e metodave të mësimdhënies së matematikës. Temat kryesore që trajtohen përfshijnë:

- Ndërlidhja e programit me kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe shkathtësi të shekullit XXI;
- Çka është matematika;
- Matematika moderne dhe shiriti i Mobiusit;
- Nxënësit me nevojë të veçanta mësimore dhe fjalori i matematikës;
- Numrat;
- Matematika në jetën reale dhe lojërat;
- Kalkulatorët dhe përdorimi i tyre;
- Puna me projekte dhe excel;
- Geogebra dhe FMS Logo;
- Aktivitete nga doracaku i matematikës dhe burimet në internet.

### Grupi i synuar

Programi i trajnimit, në radhë të parë, është konceptuar për t'u ofruar për mësimdhënësit e shkollës fillore dhe mësimdhënësit e matematikës në nivelin e mesëm të ulët. Megjithatë, programi mund të ndiqet edhe nga profesionistët tjerë arsimorë në shkollë, që mund të ofrojnë mbështetje për mësimdhënësit, apo drejtpërdrejt për nxënësit, si: mësimdhënësit mbështetës, koordinatorët e cilësisë në shkollë, etj.

### Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi i trajnimit "Zhvillimi i shkathtësive të shekullit XXI në matematikë" i ka 24 orë. Ai realizohet në formë të programit treditësh të trajnimit (18 orë), i shoqëruar me mbështetje gjatë punës në realizimin e teknikave të programit (6 orë). Forma e organizimit dhe kohëzgjatja është si vijon:

- Ofrimi i dy ditëve të para të trajnimit;
- Praktikimi i aktiviteteve të programit, mes ditës së dytë dhe ditës së tretë të trajnimit;
- Ofrimi i ditës së tretë të trajnimit;

|                                                                                   |                                    |        |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------|--------------|
|  | SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT |        | F-042        |
|                                                                                   | Prishtinë                          | v. 2.0 | Faqe 3 nga 3 |

- Zbatimi i njësive mësimore në klasa me përdorimin e metodologjisë së programit të trajnimit, i shoqëruar me mbështetje dhe informacion kthyes nga trajnerët.

### **Vlerësimi/Certifikimi**

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 24 orë (18 orë trajnimi si dhe 6 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i zbatimit të së paku dy njësive mësimore me përdorim të metodologjisë së programit të trajnimit.

### **Materialet e trajnimit**

Dokumenti kryesor për trajnimin është udhëzuesi për trajnerë që u shërben trajnerëve për ofrimin me sukses të programit të trajnimit. Trajnimi përkrahët me fletat e punës dhe me prezantimin në Power Point, sipas temave të trajnimit. Pas trajnimit, mësimdhënësve pjesëmarrës u ofrohet doracaku për mësimdhënës “Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 në lëndën e matematikës” ([https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/BEP-Math\\_shq.pdf](https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/BEP-Math_shq.pdf)) i cili u shërben në mësimdhënien e tyre.